

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE

No./No.: 08-852/3

Data/Date: 19.01.2021

Shënimi/Remarks: -5-

KINELTINËJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
 Departamenti për Profesione të Lira-Departmentant Slobodnih Profesija- Department of
 Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.25/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore dyshuar për shkelje disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbardimore në një numër rastesh përmbardimore, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike me datën 30.12.2020, dhe seancës mbi këshillim dhe votim me datën 18.01.2021, mori kurse me datën 19.01.2021 përpiloi këtë:

V E N D I M

- I. Organi përmbardues-Përmbarduesi Privat i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, pika 1.2 të LPP-së.
- II. Për kryerjen e kësaj vepre disiplinore, përmbarduesi privat, i shqiptohen masat disiplinore " Vërejtje Publike dhe "Gjobë në të holla," në shumën prej 3.000 € (tremijë Euro) e paraparë me nenin 368 par 1, pikat 1.2 dhe 1.3 të LPP-së.
- III. Detyrohet përmbarduesi privat, që të bëjë pagesën në emër të gjobës së shqiptuar me këtë vendim, në llogarinë bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, brenda afatit prej një (1) muaji duke e llogaritur nga dita e dorëzimit të këtij vendimi përmbarduesit privat.

Arsyetim

Me datën 09.11.2020, përfaqësuesi i [] iqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit privat, [] si organ përmbartues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykates [] nëmetore në Prishtinë, për shkelje të Ligjit të Procedurës Përmbartimore sepse i njëjti ka kryer një vargë shkeljes ligjore duke tejkaluar autorizimet e tij dhe se gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij nuk i është përmbartur ligjit. Pala ankuese pretendon që me datën 07.05.2019 janë njoftuar nga përmbartuesi për tre raste (CPP 2/19; CPP 7/19 dhe CPP 23/19), për të cilat gjykata kishte kërkuar nga pala kreditori që brenda afatit prej tre ditësh ta plotësoj-korrigjoj propozimin për përmbartim në atë mënyrë që të njëjtave t'ua bashkangjes faturën e nënshkruar nga pala debitorë. Sipas palës ankuese përmbartuesi privat në kundërshtim me dispozitat ligjore ka përpiluar përgjigjet dhe i kishte sjellur në [] nënshkrim dhe për vulosje, ndërsa dorëzimin e tyre e kishte bërë vet përmbartuesi privat. Po ashtu pala ankuese pretendon që me datën 25.03.2019, Gjykata Themelore në Gjilan kishte marr Aktvendim CPK 16/19 me të cilin ka pranuar prapësimin e debitorit [] sepse fatura si dokument i besueshëm në këtë rast nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe nuk është titull ekzekutiv ose nuk i plotëson tiparet e përmbartueshmërisë. Pala ankuese pretendon që vet përmbartuesi privat [] kishte përgatitur ankesën e datës 08.05.2019 dhe e kishte sjellur për ta nënshkruar dhe vulosur dhe të njëjtën ankesë me datën 19.03.2020 e kishte refuzuar si të pathemeltë. Sipas palës ankuese, edhe pse përmbartuesi ishte në dijeni që këto fatura nuk përmbajnë titull ekzekutiv, kishte marr veprime me qëllim të krijimit të vonesave, kurse në anën tjetër kishte inicuar lëndë të tjera duke e futur në këtë mënyrë [] në obligime çdo ditë e më shumë. Edhe pas Aktvendimeve të Gjykatave, sipas palës ankuese, përmbartuesi privat ka vazhduar me procesimin e lëndëve të reja. Tutje, pala ankuese thekson që përmbartuesi privat nuk ka mbartur evidencë për lëndët e përmbartuara dhe në disa raste ([] j P.nr 1626/2019 apo rasti i [] P.nr 3958/2018) i ka bllokuar llogaritë debitorëve edhe pse ata i kanë pasur të përfunduara pagesat dhe se përmbartuesi privat asnjëherë nuk iu ka dorëzuar evidencën për lëndët në përmbartim çka iu ka pamundësuar atyre procesimin e studentëve të cilët kanë kërkuar vazhdimin e studimeve për shkak të mungesës së një pasqyre të saktë se a i kanë kryer studentët pagesat e tyre.

Me datën 11.11.2020, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesionet e Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, ka paraqitur në Komisionin propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit privat [] si organ përmbartues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me veprimet përmbartimore në lëndët e paraqitura nga pala ankuese.

Përmbartuesi Privat [] në përgjigjen e tij me shkrim, deklaroi që [] në cilësinë e kreditorit ka dorëzuar tek përmbartuesi privat në total 1026 lëndë përmbartimore për procesim. Lidhur me një pjesë të tyre, pala ankuese kishte bërë ankesë në Komisionin Disiplinor dhe lidhur me ato lëndë Komisioni me Vendimin DPL 13/20 e kishte gjetur përmbartuesin përgjegjës për shkelje disiplinore. Pala ankuese përsëri nga grumbulli prej 1026 lëndë ka ushtruar ankesë në Komisionin Disiplinor. Përmbartuesi Privat thekson se në këtë rast kemi të bëjmë me kërkesë të përsëritur nga e njëjta pala ankuese, ndaj të njëjtit subjekt për shkelje të njëjta të pretenduara veçse me debitorë të ndryshëm. Sipas përmbartuesit privat, neni 101, i Ligjit nr 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili vlen edhe në këtë procedurë të Komisionit

Disiplinor, parasheh "përfundimin e procedurës administrative kur zbulon se gjatë më pakë se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike". Sa i përket lëndës disiplinore DPL 13/20, përmbaruesi privat thekson se Komisioni Disiplinor kishte vepruar në kundërshtim me nenin 367 të LPP sepse përmbaruesi privat është gjetur përgjegjës për shkelje disiplinore nga Kodi i Etikës për të cilën kompetente është Komisioni i Etikës dhe për këtë arsye edhe ka ushtruar padi pranë Gjykatës Kompetente kundër aktvendimit të Komisionit. Sa i përket tre lëndëve të theksuara nga ana e palës ankuese, përmbaruesi privat thekson se Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë, kishte kërkuar nga pala kreditore –! në afat prej 3 ditësh të dorëzojë faturën e nënshkruar nga pala debitore përndryshe konsiderohet se është tërhequr prapësimi. Përmbaruesi Privat thekson se këtë njoftim ia ka përcjellur por i njëjti nuk ka vepruar në bazë të udhëzimeve të Gjykatës. Pas marrjes së shkresave të lëndëve nga Gjykata, përmbaruesi thekson se ka nxjerr Konkluzion për përfundimin e procedurës përmbarimore, konform nenit 42 par 2 të Ligjit 04/L-139 për procedurën përmbarimore. Tutje, përmbaruesi privat thekson se sa i përket pretendimeve të tjera nëse fatura është apo jo dokument përmbarimor ato janë adresuar në lëndën disiplinore të mëparshme. Shton se ai nuk ka përpiluar ankesa sepse nuk është avokat dhe pretendimet e palës ankuese janë të pabaza. Sa i përket raportimit, shton se ai në vazhdimësi i ka raportuar kreditorit i për ecurinë e lëndëve të tyre përmbarimore. Në fund, përmbaruesi thekson se i ka transferuar shumën prej 8,588.39 Euro ndërsa shuma të cilën studentët debitor i kanë paguar drejtpërdrejt kap vlerën prej 16,712.24 Euro. ka tërhequr përmes parashtresave me vlerën 42 lëndë përmbarimore nga procedura e mëtejme në vlerë totale prej 82,467.50 Euro. Sipas përmbaruesit nëse këto shuma kanë qenë në rregull për " dhe nuk i kundërshton ndërsa për lëndët të cilat janë shfuqizuar nga gjykatat paskan qenë jo të rregullta. Meqenëse pala ankuese ka ushtruar kallëzim penal, përmbaruesi thekson se do të kërkojë përjashtimin e tij nga procesimi i mëtejme i këtyre lëndëve përmbarimore.

Me datën 30.12.2020, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore. Znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat duke theksuar se bazuar në ankesën e parastruar nga pala ankuese, përmbaruesi privat, bërë shkelje disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore duke shkelur ligjin dhe tejkalluar autorizimet ligjore.

Pala ankuese në emër të ka ngelur pranë qëndrimeve të tij dhe në Komision ka paraqitur pikëpamjet e tij duke pretenduar për shkelje disiplinore nga ana e përmbaruesit privat.

Përmbaruesi privat ka prezentuar sqarimet përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij duke theksuar se ai ka vepruar në pajtim me ligjin dhe ka kërkuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Komisioni gjatë procedurës së administrimit të provave ka lexuar provat e bashkangjitura në ankesë të evidentuara me numër 1 deri në 13, aktvendimet GJTH Pejë-Dega Klinë: CPP.7/2019

datës 18.04.2019, CPP.2/19, datës 18.04.2019, CPP nr 23/19, datës 18.04.2019, korrespondencat elektronike komunikimet, Aktvendimi i GJA AC 2922/2019, datë 19.03.2019, faturat për , faturat: 0741, 0722, 0726, 0739, 0763, 0114, 0121, 0122, 0123, 0124, 0131, 0141, 0159, 0176, 0186, 0195, 0199, 0244, 0245, 0275, 0293, 0326, 0794, 0803, 0807, 0010, 0024, 0034, 0051, 0053, 0061, 0062, 0070, 0084. Gjithashtu administrohet si provë lista me Aktvendimet të lëshuara nga Gjykatat në Kosovë mbi prapësime e ushtruar nga palët në total janë 298 aktvendime. Gjithashtu si provë administrohet propozimi shtesë i paraqitur nga pala ankuese i datës 31.08.2020, plotësim i lëndës me numër 026/2012. Po ashtu administrohen si prova edhe raportet e paraqitura nga ana e përmbauesit privat dorëzuar palës ankuese, tri konkluzionet të datës 18.09.2020, tri njoftime të dorëzuar me datën 07.05.2019, si dhe tri akte përcjellëse.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të këtij vendimi është vërtetuar në mënyrë drejtë dhe të saktë dhe se përmbauesi privat nuk ka kryer veprë disiplinore.

Komisioni gjen se përmbauesi privat kishte vepruar në kundërshtim me ligjin duke tejkaluar autorizimet e tij ligjore me rastin e zbatimit të përmbaimit mbi bazën e faturave të tilla. Nuk është kontestuese që është gjykata e cila ka kompetencë të bëjë vlerësimin nëse një dokument përmbaues është i rregullt. Siç është theksuar edhe në vendimin e Komisionit Disiplinor për Përmbauesit Privat, kompetente për trajtimin e pretendimeve përkatësisht kontestimin e dokumentit përmbaues, janë gjykatat. Neni 5 par 5 të LPP lidhur me nenin 71 të LPP shprehimisht parasheh që shkaqet për paraqitjen e prapësimit, ku mes tjerash parash që palët mund të ushtrojnë prapësim nëse “dokumenti, në bazë të cilin është marr vendimi përmbaues ose urdhri përmbaues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbaueshmërisë”. Procedura pranë Komisionit nuk është procedurë instancionale ku palët ngrisin pretendimet e tyre për çështje juridike të cilat shqyrtohen nga ana e gjykatave në procedura ligjore. Palët kanë të drejtë të shfrytëzojnë mjetet juridike në dispozicion, siç edhe ka bërë pala ankuese, për të adresuar shqetësimet dhe pretendime e saj në procedura gjyqësore. Komisioni nuk është i thirrur t’i vlerësoj apo të jap komentime përkitazi me çështjet të cilat janë në shqyrtim pranë gjykatave. Megjithatë, çështja e cila shtrohet pranë komisionit nuk është lidhur me vlefshmërinë e dokumentit përmbaues. Çështja e vlefshmërisë së faturave të lëshuara nga kolegjet private është adresuar në një numër të madh lëndësh nga ana e gjykatave në Republikën e Kosovës. Gjykatat kanë ardhur në përfundim se faturat e përpiluara nga ana e Kolegjeve Private, në këtë rast nga , nuk plotësonin kërkesat ligjore për përmbaueshmëri. Edhe Gjykata e Apelit¹ kishte theksuar që “dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaimit po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, ndërsa duke pasur parasysh edhe nenin 20 par 1.1.17 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 për Zbatimin e Ligjit mbi Administratën tatimore dhe procedurat i cili përcakton ‘në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore,’ gjykata kishte ardhur në përfundim se fatura e bashkangjitur propozimit për përmbaimit nuk i përmbushë të gjitha kushtet e parapara ligjore. Faturat e lëshuar nga i mbi bazën e të cilave është marr vendimi përmbaues

¹ AC. Nr 2922/2019 dt 19.03.2020

nuk kishin tipare të përmbueshmërisë. Pala ankuese ka paraqitur tre raste vetëm si ilustrim se si kishte vepruar përmbuesi privat. Por këtu nuk është fjala për një numër të vogël lëndësh ku gjykata ka vendosur në këtë mënyrë por për një numër relativisht të madh rastesh, siç edhe vërtetohet nga lista me numrat e lëndëve të cilën pala ankuese ia ka bashkangjitur shkresave të lëndës dhe që është administruar si provë². Faturat ishin lëshuar pas shumë vitesh për shërbime të mëhershme, nuk e përmban nënshkrimin e palës debitore dhe nuk plotësonin kushtet ligjore për përmbueshmëri. Komisioni gjen se përmbuesi ishte në dijeni për vendimet e gjykatave edhe pse pretendon se ka vendime të cilat i kanë pranuar si të rregullta edhe faturat të cilat nuk përmbajnë nënshkrimin e palës debitore. Komisioni nuk ka asnjë provë ku ndonjë gjykatë në Republikën e Kosovës të ketë pranuar pranuar kesi lloj faturash të lëshuara nga Kolegjet private si të rregullta. Rrjedhimisht, veprimi i përmbuesit mbi bazën e faturave të tilla duke qenë në dijeni se të njëjtat nuk janë të rregullta sipas vlerësimit nga gjykatat, është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Sa i përket raportimit të përmbuesit privat palës ankuese, Komisioni gjen se përmbuesi megjithatë i kishte dërguar raporte. Rrjedhimisht, Komisioni nuk gjen se përmbuesi kishte vepruar në kundërshtim me ligjin.

Komisioni vlerësoi se masat e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbuesit, sepse i njëjti ka edhe masa tjera të shqiptuara disiplinore nga Komisioni Disiplinor. Këto janë të mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe të njëjtat do të ndikojnë në përmbuesin si dhe tek përmbuesit tjerë që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masave.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBUESIT PRIVAT
DPL.nr 25/2020, datë 19.01.2021


Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISURI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

² Pala ankuese e ka bashkangjitur listën me 278, lëndë ku gjykatat kishin gjetur pa përjashtim se faturat e lëshuara nga kolegji "ISPE" nuk plotësonin kushtet ligjore për përmbueshmëri.